

Zemra e nënës



ODHISE K. GRILLO

Zemra e nënës

Ilustrimet:
Llazar Taçi

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci



BOTIMET TOENA
Tiranë 2000



LIBRERIA ARBERESH



Na ishte njëherë e një kohë që s'mbahet mend një nënë me shpirt aq të madh e aq të gjerë, sa edhe qiejt bashkë e oqeanët nuk ia kalonin dot. Në zemrën e saj kishte vend për gjithçka të bukur e të mirë që ka bota, po asnjë thërime vend për të këqiat e të shëmtuarat që ndodhin në gjithësi...

Më shumë vend nga gjithë të tjerët në zemrën e nënës zinte djali i saj.

Edhe ai, si nëna e vet, e kishte zemrën flori e shkuar floririt. Dhe donte gjithçka të mirë e urrente çdo të keqe.

Vendin kryesor në zemrën e tij e zinte e ëma, të cilën thoshin se e donte më tepër se veten e vet.



“Kështu e kështu më tha nusja... Vërtet e dua shumë se

është më e bukur e më e mirë se zanat dhe se e Bukura e

Po donte edhe një vajzë më shumë se veten e vet e se
nënën... Se ajo ishte më e bukur e më e mirë se shtojzovallet
dhe më e bukur e më e mirë se e Bukura e Dheut. Për të
linte edhe mendtë e kokës, e jepte edhe jetën e vet.

Meqë djali e donte shumë e shumë vajzën, edhe pse nëna
kishte dëgjuar se ajo ishte tepër e përkëdhelur, tekanoze
dhe e prapë, pranoi, ia dha djalit bekimin dhe çifti u martua.



Qysh ditën e parë që shkeli në shtëpinë e të shoqit, nusja nxori gjuhën e gjarprit, që e mbante të fshehur dhe derdhi një pikë helm në zemrën e burrit të vet:

- Ti do më shumë nënën tënde se mua! - i tha.
- Jo, - iu përbetua djali. - Ju dua të dyjave njëlloj e më shumë se veten.
- Ashtu? - u tërbua e shoqja. - Po të më duash njëlloj sa nënën është pak për mua. Prandaj qysh këtë çast ta ndash. E dua dashurinë tënde vetëm për vete. Nuk kam qejf ta ndaj me të tjerët.



Djali uli sytë e vari kokën dhe shkoi drejt e tek e ëma.
Zemra e nënës e ndjeu se i biri ishte i vrarë në shpirt dhe
e pyeti:

- Ç'ke o bir i nënës, që je kaq i trishtuar?
- Kështu e kështu më tha nusja... Vërtet e dua shumë se
është më e bukur e më e mirë se zanat dhe se e Bukura e
Dheut, po do ta ndaj se nuk është përmua, gjersa nuk të
do ty. Unë ju dua si sytë e ballit të dyjave.
- Fjalë është ajo, që thua, o bir? Si ta nxë goja e ta thotë
zemra ta ndash nusen, të cilën e do më tepër se veten tënde?
- Jo, o bir. Më mirë më ndaj mua, se zemra e nënës ka vend
përm gaze e helme më shumë se çdokush, në këtë e në atë
botë...



Qysh diten e pire q - Kështë me e pire q
gjarpit, që e poante fe - Dje q
të vet: Djali u kthyesh zemërvrarë tek e shoqja dhe i tha:
- Ta plotësova dëshirën, e dashur: e ndava nënën.
- Sa mirë, - u lumturua ajo dhe iu hodh në qafë. E gushi
dhe e puthi në faqe, në sy, në buzë.
- Ashtu -
për mua. Prandaj qysh këtë çast ta ndash. E dua dashurinë tëmë vetëm për
vete. Nuk kam qejf ta ndaj me të tjerët.



Nja dy ditë deti që kishte nusja në zemër ra në fashë nga gëzimi që e ndau djalin nga nëna. Mirëpo me të marrë vesh se i shoqi kishte qenë tek e ëma për vizitë, deti në zemrën e nuses ngriti dallgë e u tërbua:

- Ti s'më do mua, - i tha të shoqit si e ndërkryer. - Ti do më shumë nënën tënde. Vërtet u ndave prej saj po aty e ke mendjen, sytë, zemrën dhe këmbët që të çojnë gjithmonë te dhoma e saj.



- Jo, - iu përgjigj djali me zemrën të vrarë. - Ju dua të dyjave njëlloj e më tepër se veten time...

- Ashtu? Ti s'më dashke fare. Më shumë do nënën tënde, gjersa na do të dyjave njëlloj. Unë kërkoj të më duash vetëm mua dhe asnje tjetër. Merr vesh apo jo? Nuk dua ta ndash dashurinë më dysh. Dua të të kem vetëm përvete.

- Por përvete më ke natë e ditë. Me ty bie e me ty ngrihem. Me ty nga mëngjesi në mbrëmje e nga mbrëmja në mëngjes...

- Nuk më mjafton kaq. Dua që ta dëbosh nënën nga shtëpia dhe të mbetemi vetëm ne të dy. Kështu do të jemi të qetë e të lumtur si asnje çift tjetër.

- Si ta bëj këtë të pabërë? A dëbohet nëna që më ka bërë kokën? - u ankua djali. - A përzihet nëna nga shtëpia?

- Mirë atëherë, më dëbo mua, - iu përgjigj e shoqja. - Ose më mirë po iki vetë. - Dhe rrëmbeu këpucët e çantën në duar e iku si furtunë. Nga pas u përplas dera plot tërsëllimë.



Uli sytë e vari kokën djali dhe shkoi tek e ëma.

Zemra e nënës e ndjeu se i biri ishte i vrarë e i copëtuar në shpirt dhe e pyeti:

- Ç'ke, o bir i nënës, që je kaq i mërzitur e i dërrmuar?
- Kështu e kështu më ka thënë nusja... Vërtet e dua me shpirt se është më e mirë dhe më e bukur se zanat e malit dhe e Bukura e Dheut, po do ta nbaj se nuk është përmua gjersa nuk të do ty.

- Fjalë është ajo që thua, o bir? Si ta nxë goja e ta thotë zemra të ndash nusen, të cilën e do më tepër se veten tënde?

- Jo, o bir. Më mirë po iki unë nga shtëpia se zemra e nënës duron më shumë gaze e helme se çdokush në këtë botë. Mjafton që të jeni të lumtur...

- Thuaj se më do më shumë se veten e se nënënl



Djali shkoi zemërvrarë te shtëpia e së shoqes dhe i tha:

- Kthehu, të lutem, se ta plotësova dëshirën: nëna iku e shkoi në fshat t'i ngrysë vetëm ditët e pleqërisë dhe na bekoi përsëri e na uroi të jemi të lumtur.
- Ne do të jemi të lumtur kur të na lërë vetëm të dyve, - u gëzua e shoqja dhe iu hodh në qafë. E gushi dhe e puthi në faqe, në sy, në buzë. Dhe u kthyesh duke kërcyer në shtëpinë e të shoqit.

Nja dy ditë tufani që kishte nusja në zemër ra në fashë. Mirëpo pas një javë shpërtheu me fuqinë e skëterrës e të ferrit dhe nusja iu vërsul djalit:

- Ti s'më do mua. Vërtet e çove në fshat, po mendjen, sytë e zemrës i ke tek ajo, prandaj i dërgove para e ushqime me tët kushëri, apo jo?

përplas dera plot tërselli më.



- Ia dërgova që të mos vdesë urie e të mos lypi rrugëve, se s'ka tjetër të ardhur. Ty të dua sa s'kam fjalë si të ta tregoj. Më beso, të dua më shumë se veten time. Po edhe atë e dua, se e kam nënë...

- Ashtu? Ti s'më dashke hiç fare. Më shumë do nënën tënde. Po të më duash ashtu siç thua, shko e vraje nënën, se plakë është, e ka ngrënë çairin e vet...

Djali shkuli flokët dhe u hodh përpjetë sikur ta kishin pickuar një mijë grerëza bashkë e ta kishin kafshuar një mijë gjarpërinx tok:

- Fjalë është ajo që thua? Mblidh mendjen e veten, o grua, se unë s'vë asnje tjetër mbi ty. Ja ku po ta them për të njëmijtën herë; të dua më shumë se veten. Po edhe nënën e dua se më ka bërë kokën. Si mund ta vras me duart e mia?

Nusja përplasi këmbët në dyshemë e u hodh në tavan duke bulurit:

- Thuaj se më do më shumë se veten e se nënën!



Djali u kalamend e tha me vete:

"Këto që do t'i them tani, mos i beso, o Zot, se s'janë të vërteta. Nuk kam si
të bëj prandaj po i them... Më duhet të qetësoj nusen se është marrosur e s'di
ç'thotë... Pastaj e dua shumë se është e mirë dhe e bukur si shtojzavalle dhe
si e Bukura e Dheut".

Pasi tha kështu me vete, nxori disa fjalë si të ishte belbacuk:

- Të dua më shumë se veten, edhe më shumë se nënën...

- Atëherë merre në duar këtë shish dhe shko e ngulja nënës në zemër,
uluriti nusja si ta kishin zënë xhindet. - Dhe zemrën e saj ma sill këtu që ta
shoh me sytë e mi e të besoj se e ke vrarë me të vërtetë.



Djali u drodh si ta kishin zënë ethet e gushtit dhe iku
nga sytë këmbët me thikë në dorë e të nesërmen arriti në
fshat gjysëm i gjallë e gjysëm i çmendur.

- Vrapo për të mësja e çoja zemrën time dhe... qafshi... te lumeni



Zemra e nënës, sa e pa, e ndjeu se ç'furtunë ziente në shpirtin e të birit.

- Ç'ke, o shpirt, që je kaq i vrarë e i dërrmuar, sikur të vish nga qoftëlargu?

- Kështu e kështu më ka thënë nusja... Vërtet e dua me shpirt e më shumë se veten, se është e mirë dhe më e bukur se shtojzotvallet e se e Bukura e Dheut, po do ta ndaj se nuk është përmua gjersa kërkon të të vras e t'i çoj zemrën tënde...

- Fjalë është ajo që thua, o bir? Si ta thotë goja e si ta nxë zemra ta ndash nusen, që e do më shumë se veten tënde? Një mijë herë jo. Më mirë më vra mua se zemra e nënës duron më shumë gaze e helme se çdokush në këtë në atë botë. Unë jam plakë tani, kurse ju jeni të rinj dhe e keni përparrë jetën. Unë e hëngra jetën time dhe ditët i kam të numëruara. Ani se do të vdes, ju të jeni mirë dhe të lumtur.



Dëgjoma edhe fjalën e fundit dhe mbaje vath në vesh për tërë jetën: nusen ta duash më shumë se veten e se nënën se me atë do të jetosh. Me atë do të gëzosh, do të qash e do të qeshësh, do të lindësh e do të rritësh fëmijë...

Eja, pra, o bir, o merre zemrën time se ta jap me gjithë shpirt. Dhe çoja nuses tënde që të qetësohet, të gazmohet e të lumturohet. Se po të jesh ti me nusen i lumtur në këtë botë edhe unë do të jem e lumtur në botën e përtejme.

Dhe duke thënë këto fjalë i rrëmbeu shishin nga duart të birit.

Djali i ra në gjunjë para këmbëve dhe zuri të qajë me lot të nxeh të dukë ulëritur:

- Nënë, mos! Mos, mos, mos!

Po ishte tepër vonë: nëna e kishte çarë kraharorin me thikën që i rrëmbeu të birit, e ndau zemrën nga trupi i vet dhe ia vuri në duar duke thënë:

- Vrapo për te nusja e çoja zemrën time dhe... qofshi... të lumtur.



I mbytur nga lotët, djersët dhe gjaku që kullonte prej zemrës së nënës, djali u nis për te e shoqja duke ecur qorrazi e marramendsh se nuk shihte më as me sy e as me mendje.

Duke nxituar nëpër kalldrëmet e fshatit diku u pengua e rrëshqiti dhe u vra në ballë, në duar e në këmbë. Nga dhembja bërtiti me të madhe!

- Nënë!

- U vrave, o bir! - u dëgjua një zë i dhembshur e i shuar...

Kishte folur zemra e nënës që përpërlej ende në pëllëmbën e dorës së të birit, të cilën po ia conte nuses së vet që ishtë më e mirë e më e bukur se zanat e malit dhe se e Bukura e Dheut vetë.

LEGJENDA SHQIPTARE - 15

libra të ilustruar për fëmijë

ZEMRA E NËNËS

Autor: Odhise Grillo

Piktor: Lazar Taçi

Përkujdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjtë kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

KËSHTJELLA E ROZAFATIT

PO KU JE ADEM JASHARI?!

KOSTANDINI DHE DHOQINA

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

BILBILENJTË TREMBËDHJETË

ZEMRA E NËNËS

NORA E KELMENDIT

LULE, O ZENEL GJOLEKA!

PIRROJA I EPIRIT

DAMJAN HIMARJOT VETËTIMA

MIC SOKOLI ME SHTATË ZEMRA

BOTIMET TOENA

ISBN 99927 1 306 2